REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E DREJTËSISË**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT**
**DREJTORIA E INSPEKTIMIT**

Nr. 759 prot. Tiranë, më 13.05.2026

**VENDIM**

**Nr. 31, Datë 13.05.2026**

**"PËR**
**MIRATIMIN E INSPEKTIMIT "VEPRIMTARIA PROCEDURALE DHE ADMINISTRATIVE E ZYRËS PËRMBARIMORE TROPOJË""**

Në zbatim të nenit 8, pika c të Ligjit nr. 8/2023 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror*", Urdhrit nr. 53 Prot., nr. 06, datë 12.01.2026 "Për miratimn e Planit të Zhvillimit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror" të Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit, Urdhrit nr. 159/3 Prot., nr. 68, datë 20.06.2025 "Për miratimin e Metodologjisë së Inspektimit të Veprimtarisë së Përmbaruesve Gjyqësorë Shtetërorë", i ndryshuar, Vendimit nr. 77 Prot., nr. 03, datë 13.01.2026 "Për miratimin e Planit Vjetor të Inspektimeve për vitin 2026" të Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit, Planit të Punës për inspektimet nr. 77/1 Prot., datë 23.01.2026,

**VENDOSA:**

1. Miratimin e inspektimit "Veprimtaria procedurale dhe administrative e Zyrës Përmbarimore Tropojë", që do të kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit, sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Ngarkohet Drejtoria e Inspektimit për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse për njoftimin dhe publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**ERGYS QIRICI**



Scanned with CamScanner

**Inspektimi institucional me temë "*Veprimtaria procedurale dhe administrative e zyrës përmbarimore*", që do të zhvillohet pranë Zyrës Përmbarimore Tropojë**

| Objekti i inspektimit | Objekti i titujve ekzekutivë që do të inspektohen | Metodologjia e inspektimit | Dokumentat që do të inspektohen | Kohëzgjatja e inspektimit | Afati i dorëzimit të raportit |
|---|---|---|---|---|---|
| Ndjekja e procedurave përmbarimore konform KPC, ku ndër të tjera:<br>- Regjistrimi i kërkesës për vënien në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit, bazuar në nenin 515 të KPC;<br>- Njoftimi i akteve përmbarimore, sipas paragrafit të fundit të nenit 517 të KPC;<br>- Kalimi në ekzekutim të detyrueshëm, sipas nenit 519 të KPC;<br>- Vënia e sekuestros konservative sipas nenit 527e në vijim të KPC;<br>- Respektimi i afateve ligjore për ekzekutimin e urdhrave të ekzekutimit; | -gjoba penale;<br>-shpenzime gjyqësore;<br>-kontraktuale private;<br>-kthim shume;<br>-gjoba administrative | Verifikim nëpërmjet kërkesave për informacion;<br>Me e –mail;<br><br>Me paraqitje fizike në zyrat përmbarimore, duke kryer:<br><br>- identifikimin e dosjeve përmbarimore për secilin përmbarues bazuar në statistikat mujore dhe progresive të përmbaruesve gjyqësorë dhe zyrës përmbarimore;<br><br>-Studimin e dosjeve përmbarimore të përzgjedhura rastësisht dhe sipas kritereve të ngarkesës së përmbaruesve gjyqësorë;<br><br>- administrimin e dokumetacionit/akteve në formën e kërkuar nga ligji (vula, nr. protokollit, data etj);<br><br>- verifikimin dhe identifikimin e librit të regjistrave të protokollit në drejtim të veprimtarisë së përmbaruesve | Dosjet përmbarimore të zyrës përmbarimore, dhe çdo akt përmbarimore që gjendet në dosje.<br><br>Regjistrat e protokollit hyrës dhe dalës<br><br>Regjistrat e titujve ekzekutivë. | ZP Tropojë: 25.05.2026-26.05.2026 | Grup i Inspektimit harton Projekt raportin e inspektimit brenda një afati 30 ditësh nga përfundimi i inspektimit.<br><br>Projekt Raporti i dërgohet Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit për miratim dhe më pas përcillet për objeksione pranë zyrave përkatëse.<br><br>Grupi i Inspektimit |
| Informimi dhe sqarimi për çdo veprim procedural palët në proces ekzekutimi, sipas nenit 21, pika ç të Ligjit nr. 8/2023. | | | | | |
| Njoftimi i Prokurorisë mbi pamundësinë e ekzekutimit të titujve ekzekutivë me objekt | | | | | |



Scanned with CamScanner

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| "gjoba penale", sipas nenit 43 të Ligjit nr. 79/2020 "Për ekzekutimin e vendimeve penale" | | gjyqësorë (protokollimi i shkresave dalëse dhe hyrëse); | | | harton Raportin përfundimtar të inspektimit brenda një |
| Respektimi i rregullave të etikës dhe standardeve profesionale në marrëdhënie me palët, subjektet e tjera të përfshira në proces, kolegët, personelin dhe publikun | | - marrjen e kopjeve fizike të akteve të dosjeve përmbarimore, kjo vlerësuar sipas rastit nga ana e inspektorëve;<br><br>- verifikimin e sjelljen e përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë kundrejt qytetarëve | | | afati 30 ditësh nga miratimi Projekt Raportit. |
| Inventarizimi dhe administrimi i rregullt i të gjitha akteve përmbarimore | | Mbledhja e të dhënave statistikore dhe analizimi i tyre. | | | |
| Protokollimi shkresave hyrëse dhe dalëse dhe evidentimi në regjistrin e protokollit dhe në librin e dorëzimeve | | Takime me kryetarët dhe përmbaruesit gjyqësorë për të identifikuar problematikat. | | | |
| Zbatimi i rekomandimeve të grupeve të kontrollit nga inspektimet e mëparshme | | Krahasimi i praktikës konkrete me kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi | | | Raporti përfundimtar dorëzohet për miratim pranë Drejtorit të |
| Verifikimi i të dhënave statistikore të raportuara në DPP, nëpërmjet numërimit faktik të dosjeve përmbarimore për vitin 2026 | | | | | Përgjithshem të Përmbarimit dhe më pas u njoftohet zyrës përmbarimore të inspektuar. |



Scanned with CamScanner

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| "gjoba penale", sipas nenit 43 të Ligjit nr. 79/2020 "Për ekzekutimin e vendimeve penale" | | gjyqësorë (protokollimi i shkresave dalëse dhe hyrëse);<br><br>- marrjen e kopjeve fizike të akteve të dosjeve përmbarimore, kjo vlerësuar sipas rastit nga ana e inspektorëve;<br><br>- verifikimin e sjelljen e përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë kundrejt qytetarëve<br><br>Mbledhja e të dhënave statistikore dhe analizimi i tyre.<br><br>Takime me kryetarët dhe përmbaruesit gjyqësorë për të identifikuar problematikat.<br><br>Krahasimi i praktikës konkrete me kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi | | | harton Raportin përfundimtar të inspektimit brenda një afati 30 ditësh nga miratimi Projekt Raportit.<br><br>Raporti përfundimtar dorëzohet për miratim pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit dhe më pas u njoftohet zyrës përmbarimore të inspektuar. |
| Respektimi i rregullave të etikës dhe standardeve profesionale në marrëdhënie me palët, subjektet e tjera të përfshira në proces, kolegët, personelin dhe publikun | | | | | |
| Inventarizimi dhe administrimi i rregullt i të gjitha akteve përmbarimore | | | | | |
| Protokollimi shkresave hyrëse dhe dalëse dhe evidentimi në regjistrin e protokollit dhë në librin e dorëzimeve | | | | | |
| Zbatimi i rekomandimeve të grupeve të kontrollit nga inspektimet e mëparshme | | | | | |
| Verifikimi i të dhënave statistikore të raportuara në DPP, nëpërmjet numërimit faktik të dosjeve përmbarimore për vitin 2026 | | | | | |



Scanned with CamScanner